

(2)

REPUBLIKË SË KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIJA KUNDER KORRUPSIONIT	
AGENCJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	D.P.
Dep.	No. Prot.
Dep.	Br. Prot.
Nr. ftaq.	Prot No.
Broj stranica	03-4468/11
Nr. pages	
Dati:	
Datum:	
Date:	
14.11.2011	
PRISHTINË	

GJL.Nr.1311/2011

**GJYKATA E LARTË E KUNDËRVAJTJES NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Dalip Bega dhe Ragip Namani, anëtarë, me pjesëmarrjen e sek.juridike Sanje Salihu, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga i pandehuri Gani Mehmetaj nga Prishtina, kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, Regj.I.nr.24888/11 të dt. 14.10.2011, në bazë të nenit 39, al.3, dhe 221 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më 01.11.2011, mori

### A K T V E N D I M

Ankesa e paraqitur është pjesërisht e bazuar.

**NDRYSHOHET** aktvendimi i goditur ashtu që i pandehuri Gani Mehmetaj për kundërvajtje të kryer nga neni 16 par.1.1 të Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtare të lartë publik, dënohet me 500 Euro. Dënimin e shqiptuar i pandehuri është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 dite nga dita e marrjes së këtij aktvendimi e në të kundërtën do ti zëvendësohet me dënim burgu në kohëzgjatje prej 30 ditësh.

Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palëve.

### A r s y e t i m

Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, me aktvendimin Regj.I.nr.24888/11 të dt. 14.10.2011, ka shpall përgjegjës të pandehurin Gani Mehmetaj nga Prishtina, sepse si zyrtar i lartë drejtor i Kosova-Filmit në Prishtinë, nuk e ka bërë deklarimin e pasurisë pranë Agjencionit kundër korruptionit në afatin e caktua ligjor edhe pse ka qenë i njoftuar se është përfshirë në listën e zyrtarëve të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, të cilët janë të obliguar ta deklarojnë pasurinë, me ç,veprim ka kryer kundërvajtje nga neni 6 pika 2 lidhur me nenen 16 par.1 pika 2 të Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë publik, për të cilën kundërvajtje të pandehurit i është shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 800 Euro. Me të njëjtin aktvendim i pandehuri është i obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj 5 Euro.

Kundër këtij aktvendimi i pandehuri Gani Mehmetaj, ka paraqitur ankesë: për shkak të: shkeljeve procedurale të dispozitave kundërvajtëse, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të drejtës materiale dhe vendimit mbi dënimin e shqiptuar, ashtu siç rrjedh nga përbajtja e ankesës. Thekson se për vitin për të cilin ngarkohet nuk e ka paraqitur pasurinë nga shkaku se nuk ka pasur kurfar ndryshime dhe nuk ka qenë i njoftuar me kohë, se pasurinë e kamë paraqitur edhe vitin e kaluar dhe gjendja nuk i ka ndryshuar. Më pastaj thekson se gjoba e shqiptuar është tepër e lartë dhe rrezikon mbajtjen e familjes me një pagë mujore prej 401 Euro, nga të cilat 250 janë kredi për shtëpi dhe paime shtëpiake dhe se është hera e parë që ndeshet me Ligjin e asnjëherë nuk ka qenë i dënuar. Andaj ka propozuar që aktvendimi i goditur të abrogohet dhe lënda të kthehet në rishqyrtim ose të ndryshohet e ai të lirohet nga gjoba e shqiptuar.

Kolegji i kësaj gjykate vlerësoi thëniet në ankesën e paraqitur, aktvendimin e goditur, deklarimin e dhënë të pandehurit në seancën shqyrtimit kryesor pranë gjykatës së shkallës së parë në procesverbal të dt.09.09.2011, i cili pjesërisht e ka pranuar kundërvajtjen e cila i vihet në barrë, si dhe shkresat e tjera të lëndës, andaj ka gjetur se:

